

20150742501

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 25 dhe 47 paragrafi 1 pika 20 nga Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12 dhe 43/14), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

VENDIM PËR EMETIMIN DHE KARAKTERISTIKAT THEMELORE TË KARTËMONEDHAVE ME VLERË NOMINALE 200 DHE 2000 DENARË

1. Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë emeton kartëmonedha me vlerë nominale 200 dhe 2000 denarë, si mjet ligjor për pagesë në Republikën e Maqedonisë.

2. Kartëmonedhat me vlerë nominale 200 dhe 2000 denarë, do të shtypen në letër speciale me ngjyrë të bardhë, me filigramë, fije të ndërprerë të sigurisë me tekst të shkruar "НБРМ" (NBRM), fibra të dukshme dhe të padukshme, të shpërndara në mënyrë të parregullt që reflektojnë në të verdhë, në të gjelbër dhe të kaltër, nën ndikimin e rrezatimit ultravjollcë dhe me skajet e përforcuara në të katër anët që mundësojnë fleksibilitet dhe rezistencë ndaj dëmtimeve fizike.

Kartëmonedhat me vlerë nominale 200 denarë, shtypen në dimensione prej 146 mm në gjatësi dhe 70 mm në gjerësi.

Kartëmonedhat me vlerë nominale 2000 denarë, shtypen në dimensione prej 155 mm në gjatësi dhe 70 mm në gjerësi.

3. Kartëmonedhat nga pika 1 e këtij vendimi, kanë këto karakteristika:

3.1 Kartëmonedhat me vlerë nominale 200 denarë

Motivi bartës i pjesës së përparme të kartëmonedhës me vlerë 200 denarë, është simboli përfaqësues i terrakotës së hershme krishtere, e zbuluar në Kalanë e Vinicës, Vinicë, respektivisht relief në të cilin paraqiten luftrat e Dhiatës së Vjetër, Josiut (Jezus Navin) dhe Kalebit.

Në anën e majtë, në çerekun e sipërm të kartëmonedhës, gjendet elementi i regjistrimit - një vizatim i stilizuar marrë nga detaji i enës së mirënjohur të qeramikës (hidria) nga shekulli i 5-të p.e.s., në kombinim të ngjyrave të cilat kur e mbulojnë njëra tjetrën, formojnë vijën e jashtme të stolisë, kur shihet nën dritë. Në të, gjendet elementi i sigurisë që plotëson tiparet e filigramës të përbërë nga numri "200" dhe elementi floral i fasadës së Xhamisë së Larme, Tetovë.

Në këndin e djathtë të çerekut të parë gjendet numri "200", 18 mm i lartë. Në hijen e numrit ka shirita ngjyrash që përmbajnë shkronja "НБРМ" (BPRM) dhe numrin "200" i cili përsëritet. Në pjesën e pasme të numrit ekzistojnë shirita ngjyrash në formë të vizatimeve të stilizuara vektoriale, të cilat përsëriten dhe formojnë forma unike të punuara sipas detajeve të

mozaikëve të hershëm krishterë nga qytetet e lashta Stobi dhe Heraklea të cilat vazhdojnë në pjesën e djathtë të çerekut të tretë.

Në mes në pjesën e sipërme të çerekut të dytë të kartëmonedhës, gjendet gijoshi (guilloche), një element dekorativ i punuar nga një kombinim precizë i linjave të cilat përsëriten me detaje të hollësishme, të aplikuara në të katër anët e kartëmonedhës dhe vlera nominale e kartëmonedhës të shënuar me fjalët "двесте денари" (dyqind denarë).

Mes çerekut të parë dhe të tretë të kartëmonedhës, gjendet shenja e njohjes për personat me vështirësi në të pamur, që ka formën e një trekëndëshi të shtrirë.

Në pjesën e bardhë të zbrazur mes çerekut të parë dhe të tretë të kartëmonedhës, gjendet filigrama (ylli mbi paraqitjen e Jozueut dhe Kalebit), të dukshme nëse kartëmonedha shihet në dritë.

Në anën e njëjtë, në fushën qendrore të majtë, në formë unaze është paraqitur një fibulë bronzi nga mesjeta e hershme, nga fillimi i shekullit të 6-të. Fija e ndërprerë e sigurisë, e endura në letër, e pozicionuar në gjysmën e majtë të kartëmonedhës me gjerësi prej 3 mm në të cilën në mënyrë të përsëritur është shtypur teksti shumë i vogël "НБРМ" (BPRM) dhe vlera nominale "200" me numra. Kur shihet në pozitë të sheshtë, linjat kinetike do të ndriçojnë në ngjyrë të kuqe. Kur kartëmonedha është kthyer në një kënd, vijat kinetike lëvizin dhe ndryshojnë në të gjelbër. Në këndin e djathtë lartë, në çerekun e dytë, gjendet teksti "двесте денари" (dyqind denarë), i lartë 6 mm.

Në këndin e djathtë të çerekut të dytë, në fund të pjesës së shtypur të kartëmonedhës, vertikalisht me shkronja të vogla është shkruar teksti "Јошуа и Калѣб, теракотна икона, Винаца, 6-7 век" (Jozueu dhe Kalebi, ikona terrakote, Vinicë, shekulli 6-7).

Në pjesën e majtë të çerekut të tretë është paraqitur një zog i marrë nga mozaiku i dyshemesë nga Baptisteri i Bazilikës Peshkopale në Stobi. Nën paraqitjen e zogut me shkronja të vogla është shkruar teksti që shënon vendin dhe datën e emetimit të kartëmonedhës, dhe nën atë tekst nënshkrimi faksimil i guvernatorit dhe teksti "Гувернер" (Governator).

Në pjesën e poshtme, mes çerekut të tretë dhe të katërt të kartëmonedhës, është i shkruar mikroteksti "Народна банка на Република Македонија" (Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë). Nën të gjendet teksti "Народна банка на Република Македонија" (Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë), 4 mm i lartë.

Në këndin e djathtë të poshtëm të çerekut të fundit, gjendet numri "200", 6 mm i lartë.

Motivi bartës i pjesës së prapme të kartëmonedhës prej 200 denarë, është një element arti arkitekturor i fasadës së Xhamisë së Larme në Tetovë. Ajo është plotësuar me elemente florale të marra nga dekorimi i dyshemeve të mermerit të Xhamisë së famshme Isak Çelebi në Manastir.

Në pjesën e sipërme dhe të poshtme të kartëmonedhës gjendet një mikrotekst "НБPM" (BPRM) dhe "200", i cili përsëritet në sfonde të ndryshme, në kombinim negativ dhe pozitiv me ngjyra që përputhen me ngjyrat e kartëmonedhës.

Në çerekun e parë të këndit të majtë të sipërm, gjendet numri "200", 6 mm i lartë.

Në mesin e çerekut të parë dhe të tretë, vertikalisht është vendosur shiriti i ngjyrosur me shkëlqim metali, në të cilin nën kënd të caktuar duket flamuri i Republikës së Maqedonisë dhe numri "200".

Mes çerekut të parë dhe të dytë, gjendet tekst "Народна банка на Република Македонија" (Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë), 4 mm i lartë. Numri serik i kartëmonedhës që përmban 2 shkronja dhe 6 numra, është i shtypur në pjesën e majtë të çerekut të parë dhe të tretë të kartëmonedhës në pozicion vertikal, ndërsa në çerekun e katërt të kartëmonedhës, në pozicion horizontal.

Në këndin e majtë të çerekut të dytë, ka shirita ngjyrash në formë të vizatimeve të stilizuara vektoriale, të cilat përsëriten dhe formojnë forma unike të punuara sipas detajeve nga mozaikët e hershëm krishterë nga Stobi dhe Heraklea, që vazhdojnë edhe në çerekun e katërt të kartëmonedhës. Në mes të pjesës së sipërme të çerekut të dytë, është i shkruar teksti "Шарена Џамија, детаљ од фасада, Тетово, 15 век." (Xhamia e Larme, detaj nga fasada, Tetovë, shek 15).

Në pjesën e djathtë të çerekut të katërt, është vendosur një model i rrjetës i përbërë nga vija të bardha të kthyera nën kënde të ndryshme. Në pjesën e djathtë lartë të çerekut të dytë, gjendet elementi i regjistrimit - një vizatim i stilizuar i marrë nga detaje nga ena e mirënjohur e qeramikës (hidria) nga shekulli i 5-të p.e.s. Në mes të pjesës së majtë dhe të djathtë të kartëmonedhës është paraqitur një vizatim i stilizuar, elemente florale nga dekorimi i dyshemeve të mermerit të Xhamisë së famshme Isak Çelebi në Manastir, i cili, kur paloset kartëmonedha, formon një pamje të plotë. Në pjesën e poshtme të këndit të majtë të çerekut të tretë, gjendet teksti "двесте денари" (dyqind denarë) në lartësi prej 6 mm.

Në këndin e majtë të çerekut të katërt, gjendet numri "200", 18 mm i lartë. Në hijen e numrave ka ngjyra që përmbajnë shkronjat "НБPM" (BPRM) dhe numrin "200" i cili përsëritet.

Në çerekun e parë dhe të tretë të kartëmonedhës, është integruar element i përbërë nga detajet florale të cilat nën dritë ultraviolet ndryshojnë në dy ngjyra që lënë përshtypje vizuele dhe janë lehtë të dallueshme.

3.2 Kartëmonedhat me vlerë nominale 2000 denarë

Motiv bartës i pamjes së përparme të kartëmonedhës me vlerë 2000 denarë, është paraqitja e një kostumi martesor nga Fusha e Prilepit si reflektim i pasurisë së trashëgimisë folklorike të Republikës së Maqedonisë. Në anën e njëjtë, në pjesën qendrore të majtë, është paraqitur një varëse në formë të lules së afionit, që paraqet artefakt i cili daton nga shekulli i 7

p.e.s..

Në çerekun e parë të pjesës së majtë të sipërme të kartëmonedhës, gjendet elementi i regjistrimit - një vizatim i stilizuar i bazuar në një detaj nga një mozaik i hershëm krishterë nga Stobi, i cili në kombinim me ngjyra, kur mbulojnë njëra tjetrën, formojnë një vijë të jashtme mbi stolinë, kur shihet nën dritë.

Nën të, gjendet një element i sigurisë që plotëson tiparet e filigramës të përbëra nga numri "2000" dhe vulën argjilore neolitike, e zbuluar në vendin arkeologjik Govrlevo, Shkup.

Në këndin e djathtë të çerekut të parë gjendet numri "2000", 18 mm i lartë. Në hijen e numrit ka ngjyra që përmbajnë shkronja "НБРМ" (BPRM) dhe numrin "2000" i cili përsëritet.

Në pjesën e prapme të numrave ka vija ngjyrash në formë të vizatimeve stilizuese vektoriale të cilat përsëriten dhe formojnë forma unike të punuara sipas detajeve nga mozaikët e hershëm krishterë nga Stobi dhe Heraklea dhe detajet e veshjeve kombëtare të cilat vazhdojnë edhe në tre çerekët e tjera të kartëmonedhës.

Në mes në pjesën e sipërme të çerekut të dytë të kartëmonedhës, gjendet gijoshi (guilloche), një element dekorativ i punuar nga një kombinim i saktë i linjave të përsëritura me detale të hollësishme, të aplikuara në të katër anët e kartëmonedhës, dhe vlera nominale e kartëmonedhës e shënuar me fjalët "две илјади денари" (dy mijë denarë).

Mes çerekut të parë dhe të tretë të kartëmonedhës, është shtypur shenja e njohjes për personat me vështirësi në të pamur, që ka formën e tre drejtkëndëshve të shtrirë. Në pjesën e bardhë mes çerekut të parë dhe të tretë të kartëmonedhës gjendet filigrama (fytyra e vajzës me kostum martesor), e cila është e dukshme nëse kartëmonedha shihet në prapavijë të ndriçuar.

Në anën e njëjtë, në pjesën qendrore të majtë, është paraqitur një varëse në formë të lules së afionit, që paraqet artefakt të datuar në shekullin e 7 p.e.s.

Fija e ndërprerë e sigurisë, e endura në letër, e pozicionuar në gjysmën e majtë të kartëmonedhës në formë të gërshetuar, e përbërë nga dy shirita me gjerësi prej 4 mm në të cilën në mënyrë të përsëritur është shtypur teksti shumë i vogël "НБРМ" (BPRM) dhe vlera nominale "2000". Kur shihet në pozitë të sheshtë, linjat kinetike do të ndriçojnë në ngjyrë të kuqe. Kur kartëmonedha është kthyer në një kënd, vijat kinetike lëvizin dhe të ndryshojnë në të gjelbër. Në këndin e djathtë lartë, në çerekun e dytë, gjendet teksti "две илјади денари" (dy mijë denarë), i lartë 6 mm.

Në pjesën e majtë të çerekut të tretë është paraqitur një zbukurim (zbukurim në rripat e nuseve) nga fshati Velgoshti, Ohër, shek. 19. Nën paraqitjen e zbukurimit, me shkronja të vogla është shkruar teksti që shënon vendin dhe datën e emetimit të kartëmonedhës, dhe nën atë tekst nënshkrimi faksimil i guvernatorit dhe teksti "Гувернер" (Guvernator).

Në pjesën e poshtme, mes çerekut të tretë dhe të katërt të kartëmonedhës, është shkruar mikroteksti "Народна банка на Република Македонија" (Banka Popullore e Republikës së

Maqedonisë). Nën të gjendet teksti "Народна банка на Република Македонија" (Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë), 4 mm i lartë.

Në këndin e djathtë të poshtëm të çerekut të fundit, gjendet numri "2000", 6 mm i lartë.

Në këndin e djathtë të çerekut të katërt, në fund të pjesës së shtypur të kartëmonedhës, vertikalisht me shkronja të vogla është shkruar teksti "Невестинска носија, Прилепско Поле, 19 век" (Kostum martesor, Fusha e Prilepit, shekulli 19).

Në pjesën e majtë të çerekut të dytë ka një element të sigurisë, modeli i të cilit është pamja e përparme e një monedhe antike nga shek. 2 p.e.s. Në këtë element, varësisht nga këndi nga i cili shikohet, shfaqet një unazë rreth pjesës qendrore, e cila e ndryshon pozicionin dhe ngjyrën duke krijuar një efekt tre-dimensional.

Motivi bartës i pjesës së prapme të kartëmonedhës prej 2000 denarë, është dekorimi i pjesës së brendshme së një ene të larë në arë, e cila ka origjinën nga shekulli i 16-të, ku në pjesën qendrore janë dy pallonj afrontal (zogjtë e parajsës) pranë "burimit të jetës" të rrethuar nga dekorim të shumtë floral.

Në pjesën e sipërme dhe të poshtme të kartëmonedhës gjendet mikroteksti "НБРМ" (BPRM) dhe "2000", i cili përsëritet në sfonde të ndryshme, në kombinim negativ dhe pozitiv me ngjyra që përputhen me ngjyrat e kartëmonedhës.

Në këndin e majtë të sipërm, gjendet numri "2000", 6 mm i lartë.

Në mesin e çerekut të parë dhe të tretë, vertikalisht është vendosur shiriti i ngjyrosur me shkëlqim metali, në të cilin nën kënd të caktuar duket flamuri i Republikës së Maqedonisë dhe numri "2000". Mes çerekut të parë dhe të dytë, gjendet tekst "Народна банка на Република Македонија" (Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë), 4 mm i lartë. Numri serik i kartëmonedhës që përmban 2 shkronja dhe 7 numra, është i shtypur në pjesën e majtë të çerekut të parë dhe të tretë të kartëmonedhës në pozicion vertikal, ndërsa në çerekun e katërt të kartëmonedhës, në pozicion horizontal.

Në këndin e majtë të çerekut të dytë, ka shirita ngjyrash në formë të vizatimeve të stilizuara vektoriale, të cilat përsëriten dhe formojnë forma unike të punuara sipas detajeve nga mozaikët e hershëm krishterë nga Stobi dhe Heraklea, që vazhdojnë edhe në çerekun e katërt të kartëmonedhës. Në mes të pjesës së sipërme të çerekut të dytë, është i shkruar teksti "Сад, сребро со позлата, Скопје, 16 век." (Enë argjendi e larë në arë, Tetovë, shek 16).

Në pjesën e djathtë të çerekut të dytë, është vendosur një model i rrjetës i përbërë nga vija të bardha të kthyer në kënde të ndryshme. Në pjesën e djathtë lart, të çerekut të dytë, gjendet elementi i regjistrimit - një vizatim i stilizuar i bazuar në detaje nga mozaiku i Stobit. Në mes të pjesës e majtë dhe të djathtë të kartëmonedhës është të paraqitur një vizatim i stilizuar, elemente florale nga dekorimi i pjesës së brendshme të një ene të larë në arë, e cila,

kur paloset kartëmonedha, formon një pamje të plotë. Në pjesën e poshtme të këndi të majtë të çerekut të tretë, gjendet teksti "две илјади денари" (dy mijë denarë) në lartësi prej 6 mm.

Në këndin e majtë të çerekut të katërt, gjendet numri "2000", 18 mm i lartë. Në hijen e numrave ka ngjyra që përmbajnë shkronjat "НБРМ" (BPRM) dhe numrin "2000" që përsëritet.

Në pamjen e prapme të kartëmonedhës, është integruar element – pamje e dy zogjëve, të cilat nën dritë ultraviolet ndryshojnë në dy ngjyra që lënë përshtypje vizuale dhe janë lehtë të dallueshme.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Nr.V. 02-15/IV-1/2015
30 prill viti 2015
Shkup

Guvernator dhe Kryetar
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov